**Spiecapag Shqipëria Degë e Shoqërise së huaj**
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

**PËRMBAJTJA**


| | FAQE |
|---|---|
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 1 |
| PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE | 2 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL | 3 |
| PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE | 4 |
| SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE | 5 – 21 |

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**
**më 31 dhjetor 2017**

| | Shënime | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVE** | | | |
| **Aktivet afatgjata** | | | |
| Aktivet afatgjata materiale | 6 | 1,368,613,949 | 1,396,939,192 |
| **Totali i aktiveve afatgjata** | | **1,368,613,949** | **1,396,939,192** |
| **Aktivet afatshkurtra** | | | |
| Inventarë | 7 | 59,870,203 | 679,444,069 |
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 8 | 3,864,204,116 | - |
| Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura | 9 | 83,711,400 | 4,037,971,410 |
| Llogari të arkëtueshme të tjera | 10 | 122,835,540 | 455,769,162 |
| Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra | 11 | 569,709,881 | 41,252,589 |
| Mjetet monetare në arkë e në bankë | 12 | 5,955,921,906 | 12,351,298,250 |
| **Totali i aktiveve afatshkurtra** | | **10,656,253,046** | **17,565,735,480** |
| **Totali i aktiveve** | | **12,024,866,995** | **18,962,674,672** |
| | | | |
| **KAPITALI** | | | |
| Rezerva të tejra | | 1,559,343,984 | - |
| Fitimi i ushtrimit | | 2,002,922,517 | 1,559,343,984 |
| **Totali i kapitalit** | **13** | **3,562,266,501** | **1,559,343,984** |
| **DETYRIMET** | | | |
| **Detyrime afatgjata** | | | |
| Llogari të pagueshme tregtare | 14 | 186,409,275 | - |
| Hua afatgjata nga ortaku | 15 | - | 184,862,253 |
| **Totali i detyrimeve afatgjata** | | **186,409,275** | **184,862,253** |
| **Detyrime afatshkurtra** | | | |
| Llogari të pagueshme tregtare | 16 | 353,245,269 | 990,225,811 |
| Llogari të pagueshme nga palët e lidhura | 17 | 2,459,071,331 | 8,470,724,906 |
| Parapagimet e arkëtuara | 18 | 5,436,256,280 | 7,469,705,465 |
| Detyrime tatimore | 19 | 2,618,339 | 287,812,253 |
| Provizione | 20 | 25,000,000 | - |
| **Totali i detyrimeve afatshkurtra** | | **8,276,191,219** | **17,218,468,435** |
| **Totali i detyrimeve** | | **8,462,600,494** | **17,403,330,688** |
| **Totali i kapitalit dhe detyrimeve** | | **12,024,866,995** | **18,962,674,672** |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

*(Vlerat janë në Lek)*

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|---|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 21 | 29,356,050,566 | 15,036,051,650 |
| Të ardhura të tjera | 22 | 1,313,632 | - |
| **Total të ardhura** | | **29,357,364,198** | **15,036,051,650** |
| Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | 23 | (25,753,396,374) | (12,526,382,064) |
| Shpenzime personeli | 24 | (113,562,496) | (199,994,427) |
| Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi | 25 | (286,985,360) | (31,999,293) |
| Shpenzime të tjera të shfrytëzimit | 26 | (809,442,670) | (252,054,887) |
| **Total shpenzime** | | **(26,963,386,900)** | **(13,010,430,671)** |
| Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto) | 27 | 70,530 | 41,234 |
| Shpenzime të tjera financiare (neto) | 28 | 9,203,765 | (182,251,177) |
| **Fitimi/humbja para tatimit** | | **2,403,251,593** | **1,843,411,036** |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | 29 | **(400,329,076)** | **(284,067,052)** |
| Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | | (397,700,430) | (284,067,052) |
| Korrigjimi i tatim fitimit | | (2,628,646) | - |
| **Fitimi/humbja e vitit** | | **2,002,922,517** | **1,559,343,984** |
| Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin | | - | - |
| **Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin** | | - | - |
| **Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin** | | **2,002,922,517** | **1,559,343,984** |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Spiecapag Shqipëria

Pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Vlerat janë në Lek)*

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital**

**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

| | Kapitali i nënshkruar | Rezerva të tejra | Fitim / Humbja e vitit | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015** | - | - | - | - |
| Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin: | | | 1,559,343,984 | 1,559,343,984 |
| Të ardhura gjithëpërfshirëse të tjera për vitin: | | | | - |
| **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016** | - | - | 1,559,343,984 | 1,559,343,984 |
| Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin: | | | 2,002,922,517 | 2,002,922,517 |
| Të ardhura gjithëpërfshirëse të tjera për vitin : | | 1,559,343,984 | (1,559,343,984) | - |
| **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017** | - | 1,559,343,984 | 2,002,922,517 | 3,562,266,501 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratorët e Spiecapag Shqipëria më __________ dhe janë firmosur si më poshtë.

Z. Eric Eros Azika
Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit

Z. Guillaume Batut
Administrator

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|---|
| **Flukset e parasë nga aktivitetet operative** | | | |
| **Fitimi para tatimit** | | 2,403,251,593 | 1,843,411,036 |
| *Axhustime për zërat jo-monetare:* | | | |
| Amortizimi | | 286,985,360 | 31,999,293 |
| Provizione | | 25,000,000 | - |
| Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi kapital | | (2,103,367) | - |
| *Ndryshimi ne kapitalin qarkullues* | | | |
| Rënie/(rritje) në inventar | | 619,573,866 | (679,444,069) |
| Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera | | 422,989,516 | (4,493,740,572) |
| Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera | | (7,147,747,832) | 9,464,695,918 |
| Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra | | (528,457,292) | (41,252,589) |
| Ndryshimi ne te ardhura te shtyra | | (2,033,449,185) | 7,469,705,465 |
| **Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative** | | **(5,953,957,341)** | **13,595,374,482** |
| Interesa të paguara | | - | - |
| | | - | - |
| **Aktivitetet investuese** | | | |
| Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale | | (305,144,276) | (1,428,938,485) |
| Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale | | 48,587,526 | |
| **Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues** | | **(256,556,750)** | **(1,428,938,485)** |
| **Aktivitetet financuese** | | | |
| (Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata | | (184,862,253) | 184,862,253 |
| **Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues** | | **(184,862,253)** | **184,862,253** |
| **Ndryshimi neto i mjeteve monetare** | | **(6,395,376,344)** | **12,351,298,250** |
| Mjetet monetare në fillim të periudhës | | 12,351,298,250 | - |
| **Mjetet monetare në fund të periudhës** | **12** | **5,955,921,906** | **12,351,298,250** |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1. Informacion i përgjithshëm

Spiecapag Shqipëria me formë ligjore Degë e Shoqërisë së huaj është regjisturar më 08/12/2015 në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" dhe statuti i saj. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj dhe ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare".

Objektet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë janë dizenjo, inxhinieri dhe ndërtim, asistencë teknike pë impiante dhe makineri të rënda, ndërtimi dhe mirëmbajtje e impianteve përkohësisht përfshirë shërbime në terren. Shoqëria kryen çdo lloj transporti në Shqipëri, si edhe çdo aktivitet tjetër për nevojat e transportit apo nevoja të tjera në kuadër të Projektit TAP.

Administratorë të Shoqërisë janë Z. Guillaume Batut dhe Z. Olivier Thierry Marie Balloy. Adresa e Shoqërisë është Rr. "Ibrahim Rugova", nr.5, Sky Tower, 13/4, 1000 Tiranë dhe është e regjistruar si person juridik në Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj me L61402015T.

Në 31 dhjetor 2017 shoqëria ka patur 23 punonjës, (2016 : 22 punonjës).

## 2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

### 2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen në periudhat e raportimit financiar që fillojnë me ose pas datës 1 janar 2017.

- Përmirësimet vjetore të SNRF (Cikli 2014 - 2016): SNRF 12 Shpalosjen e interesave në njësi të tjera
- SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat (Amendim – Njohja e taksës së shtyrë si asset për humbje të parealizuara).
- SNK 7 Pasqyra e Flukseve Monetare (Shpalosjen e Amendimeve fillestare)

### 2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar, por nuk jane ende efektive:

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël të cilat behën efektive në periudhat e ardhshme kontabël dhe që kompania nuk ka vendosur ti pervetësojë më shpejt. Më të rëndësishmet janë:

- ***SNRF 9*** *Blerësit e instrumentave financiar* (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date)
- ***SNRF 15*** *Të ardhurat nga kontratat me blerësit* (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date); dhe
- ***SNRF 16*** *Qiratë* (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2019 ose pas kësaj date)
- **Të tjera**

Kompania nuk parashikon standard të tjerë të publikuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël, që nuk janë në përdorim, të kenë ndikim material në pasqyrat financiare.

- *KIRFN 22 Përkthimin e Monedhave të huaja dhe Vlerësimin në Avancë (në fuqi më 1 Janar 2018)*
- *Amendime të klasifikimeve të SNRF 2 dhe Matja e Transaksioneve me Pagesë Aksionesh (në fuqi më 1 Janar 2018)*

**2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)**

**2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara (vazhdim)**

- *Amendime të SNA 40: Transfertat e Pasurive Investuese (në fuqi më 1 Janar 2018)*
- *Përmirësime vjetore të Standardeve SNRF, cikli 2014 – 2016, që ndeshet me çështjet e SNRF 1 për herë të parë*
- *Adoptimi dhe SNA 28 Investime në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (në fuqi më 1 Janar 2018)*
- *KIRFN 23 Paqartësi mbi Pozicionin e Taksës mbi të Ardhurat (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)*
- *Amendime të SNRF 9 Karakteristikat e Parapagimeve me Kompensim Negativ (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)*
- *Amendime të SNA 28: Interesat Afatgjatë në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)*
- *SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (hyn në fuqi më 1 Janar 2021)*

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

**3. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

**3.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**3.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

**3.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**3.5. Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.
Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.
Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

### 3. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

### 3.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

#### 3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### 4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 4.5. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

| **Kursi i këmbimit** | **2017** | **2016** |
|---|---|---|
| EUR/Lek | 132.95 | 135.23 |
| USD/ Lek | 111.10 | 128.17 |

### 4.6. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.
Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

## 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

### 4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogaritë e pagueshme*
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Huatë*
Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së kostos së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

*Vlera e drejtë*
Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

*Të tjera*
Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

*Zhvlerësimi i aktiveve financiare*
Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.
Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.
Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.
Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

### 4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.
Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

### 4.4 Aktive afatgjata materiale

*i. Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.
Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.
Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.
Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

*ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

| Kategoria e aktiveve | Metoda e Amortizimit | Norma e Amortizimit |
|---|---|---|
| Ndërtesa dhe instalime | Vlera e mbetur | 5 % |
| Makineri dhe pajisje | Vlera e mbetur | 20 % |
| Mjete transporti | Vlera e mbetur | 20 % |
| Pajisje informatike | Vlera e mbetur | 25 % |
| Mobilje e orendi | Vlera e mbetur | 20 % |

Toka nuk amortizohet.
Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet.
Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

**4. Politikat Kontabël (vazhdim)**

**4.4 Aktive afatgjata materiale**

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**4.5 Kosto e huamarrjes**

Kostot e huave te lidhura direkt me blerjen, ndertimin ose prodhimin te aktiveve, te cilat duan nje kohe te gjate për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

**4.6. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**4.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

**4.8. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.
Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.
Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.
Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

## 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

### 4.9. Përfitimet e punëmarrësve

*Kontributet e detyrueshme shoqërore*

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

### 4.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë dhe Manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### 4.11. Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### 4.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nësë është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## 5. GJYKIME DHE VLERËSIME KRITIKE TË KONTABILITETIT

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

*Tatimi mbi fitimin*

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

*Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale*

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

*(Vlerat janë në Lek)*

## 6. Aktive Afatgjata Materiale

Aktivet Afatgjata Materiale më 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

| | Ndërtesa | Makineri dhe Pajisje | Mjete transporti | Pajisje informatike | Mobilje e pajisje zyre | Në proces | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Kosto*** | | | | | | | |
| Gjendja më 1 janar 2016 | | | | | | | - |
| Shtesa | 111,530,610 | 312,602,264 | 497,838,419 | 22,676,367 | 11,985,448 | 472,305,377 | **1,428,938,485** |
| Transferime | | | | | | | - |
| Pakësime | | | | | | | - |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2016** | **111,530,610** | **312,602,264** | **497,838,419** | **22,676,367** | **11,985,448** | **472,305,377** | **1,428,938,485** |
| Shtesa | 58,494,586 | 190,999,474 | 54,421,727 | 973,407 | 255,082 | | **305,144,276** |
| Transferime | 472,305,377 | | | | | (472,305,377) | - |
| Pakësime | | (41,170,015) | (7,417,511) | | | | **(48,587,526)** |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2017** | **642,330,573** | **462,431,723** | **544,842,635** | **23,649,774** | **12,240,530** | - | **1,685,495,235** |
| | | | | | | | - |
| ***Zhvlerësimi i akumuluar*** | | | | | | | - |
| Gjendja më 1 janar 2016 | | | | | | | - |
| Amortizimi i vitit | 1,867,082 | 9,124,813 | 17,417,772 | 2,431,899 | 1,157,727 | | **31,999,293** |
| Kthim amortizimi | | | | | | | - |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2016** | **1,867,082** | **9,124,813** | **17,417,772** | **2,431,899** | **1,157,727** | - | **31,999,293** |
| Amortizimi i vitit | 107,383,946 | 71,366,128 | 100,893,497 | 5,142,234 | 2,199,555 | | **286,985,360** |
| Pakësime | | (1,389,674) | (713,693) | | | | **(2,103,367)** |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2017** | **109,251,028** | **79,101,267** | **117,597,576** | **7,574,133** | **3,357,282** | - | **316,881,286** |
| *Vlera neto kontabël* | | | | | | | |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2016** | **109,663,528** | **303,477,451** | **480,420,647** | **20,244,468** | **10,827,721** | **472,305,377** | **1,396,939,192** |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2017** | **533,079,545** | **383,330,456** | **427,245,059** | **16,075,641** | **8,883,248** | - | **1,368,613,949** |

## 7. Inventarë

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Lëndë ndihmëse dhe të konsumueshme | 59,870,203 | 366,129,116 |
| Punime në proces të pa certifikuara | - | 313,314,953 |
| | **59,870,203** | **679,444,069** |

## 8. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Klientë | 3,864,204,116 | - |
| | **3,864,204,116** | **-** |

## 9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Spiecapag Transadriatica kërkesa të arkëtueshme tregtare | 83,711,400 | 3,956,479,669 |
| Spiecapag France të tjera kërkesa të arkëtueshme | - | 81,491,741 |
| | **83,711,400** | **4,037,971,410** |

## 10. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| TVSH e kreditueshme | 5,501,039 | 387,591,774 |
| TVSH per tu regulluar | 307,978 | 65,548,042 |
| Detyrime doganore | 1,275,202 | 444,705 |
| Garanci te paguara | 1,037,010 | 1,154,245 |
| Të tjera të arkëtueshme | 1,581,590 | 1,030,396 |
| Tatim fitim I rimbursueshëm | 113,132,721 | - |
| | **122,835,540** | **455,769,162** |

## 11. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Parapagime për furnizime | 499,415,250 | - |
| Shpenzime të shtyra per prime sigurimi | 70,294,631 | 41,252,589 |
| | **569,709,881** | **41,252,589** |

## 12. Mjete monetare në arkë dhe në bankë

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Likuiditete në bankë | 5,948,333,898 | 12,340,221,868 |
| Likuiditete në arkë | 7,588,008 | 11,076,382 |
| | **5,955,921,906** | **12,351,298,250** |

## 13. Kapitali

Shoqëria është degë e një shoqërie të huaj dhe nuk ka kapital të regjistruar.

Rezerva të tejra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë: 1,559,343,984 Lek.

Fitimi i ushtrimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është: 2,022,922,517 Lek.

## 14. Llogari të pagueshme tregtare afatgjata

Hua afatgjata nga ortaku më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Llogari të pagueshme tregtare | 186,409,275 | - |
| | **186,409,275** | **-** |

## 15. Hua afatgjata nga ortaku

Hua afatgjata nga ortaku më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Financime nga SC France | - | 184,862,253 |
| | **-** | **184,862,253** |

## 16. Llogari të pagueshme tregtare afatshkurta

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Llogari të pagueshme tregtare | 241,002,915 | 990,225,811 |
| Furnitorë për fatura të pambërritura | 112,242,354 | - |
| | **353,245,269** | **990,225,811** |

## 17. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Llogari të pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Spiecapacg France | 744,016,460 | 3,605,108,342 |
| Spiecapag Transadriatica | 1,715,054,871 | 4,865,616,564 |
| | **2,459,071,331** | **8,470,724,906** |

## 18. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Parapagime nga klientë | 3,209,898,002 | 7,008,931,815 |
| Të ardhura të shtyra | 2,226,358,278 | 460,773,650 |
| | **5,436,256,280** | **7,469,705,465** |

## 19. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 861,214 | 850,471 |
| Detyrime për tatim page | 1,402,965 | 2,023,985 |
| Detyrime për tatim në burim | 354,151 | 870,745 |
| Detyrim tatim fitimi | - | 284,067,052 |
| | **2,618,330** | **287,812,253** |

## 20. Provizione

Provizionet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Provizione | 25,000,000 | - |
| | **25,000,000** | - |

## 21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 29,356,050,566 | 14,722,736,719 |
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit të pa aprovuara | - | 313,314,931 |
| | **29,356,050,566** | **15,036,051,650** |

**Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:**

| | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| **Rakordimi i të ardhurave me FDP-në** | |
| Qarkullim i tatueshëm | 27,323,331,202 |
| Zbriten Autofaturimet 2016 | |
| Zbriten parapagimet dhe të ardhurat e shtyra | 2,033,449,183 |
| Zbriten vlera e kthimit të pjesëve dhe pajisjeve paraqitur për neto | (729,819) |
| **Shuma e qarkullimit e korrektuar** | **29,356,050,566** |
| Sipas Kontabilitetit | 29,356,050,566 |
| **Diferenca** | - |
| Të ardhura nga këmbimet valutore | 346,712,899 |
| Të ardhura nga interestat | 41,234 |
| **Total të ardhura deklaruar në FDP-në e Tatim Fitimit** | **29,702,804,699** |

## 22. Të ardhura të tjera

Të ardhurat të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Të ardhura nga shitja e aseteve fikse | 1,313,632 | - |
| | **1,313,632** | **-** |

| | | |
|---|---|---|
| ***Dalja jashte perdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale*** | | |
| Te ardhura nga shitja e AAM | 8,017,450 | - |
| Shpenzime nga shitja e AAM | (6,703,818) | - |
| Te ardhura nga shitja e AAM | 39,780,341 | |
| Shpenzime nga shitja e AAM | (39,780,341) | |
| **Rezultati Neto nga shitja e AAM** | **1,313,632** | **-** |

Shoqeria kishte blere disa AAM nga mema e saj gjate vitit 2016, per te cilat gjate vitit 2017 shoqeria meme vendosi te anolloje shitjen e AAM dhe te perfshije keto AAM ne listen e AAM te tjera te dhena me qira deges ne Shqiperi. Per kete qellim gjate vitit 2017 jane hequr nga kontabilitetit vlera e mbetur e AAM dhe eshte regjistruar si e ardhur per te njejten shume 39,780,341 leke.

## 23. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e pare dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Lëndë ndihmëse dhe te konsumueshme | 311,590,049 | 873,486,246 |
| Zbriten vlera e kthimit te pjeseve dhe pajisjeve paraqitur per neto | (7,462,446) | (108,502,744) |
| Lëndë djegëse | 5,798,100 | 71,111,747 |
| Pjesë këmbimi | 646,080,417 | 316,569,159 |
| Qera Pajsje | 2,842,743,619 | 2,143,718,975 |
| Qera kampi | 819,647,522 | 204,085,221 |
| Nenkontraktore | 19,707,280,141 | 7,702,166,710 |
| Sherbime teknike dhe te manxhimit | 1,089,493,288 | 939,494,842 |
| Mirembajtje dhe riparime | 50,264,380 | 24,580,407 |
| Shpenzime transporti | 287,961,304 | 359,671,501 |
| | **25,753,396,374** | **12,526,382,064** |

## 24. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

| | **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017** | **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016** |
|---|---|---|
| Shpenzime për paga | 107,918,520 | 190,715,244 |
| Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore | 5,643,976 | 9,279,183 |
| | **113,562,496** | **199,994,427** |

## 25. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

| | **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017** | **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016** |
|---|---|---|
| Shpenzime amortizimi | 286,985,360 | 31,999,293 |
| | **286,985,360** | **31,999,293** |

## 26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017** | **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016** |
|---|---|---|
| Blerje energji,avull,ujë karburant | 17,915,845 | 4,782,224 |
| Mirëmbajtje dhe riparime | 79,909,482 | 11,486,459 |
| Sigurime | 70,594,999 | 29,653,659 |
| Udhetime e dieta | 702,757 | 44,610,097 |
| Shpenzime per granci | 38,020,222 | 44,639,734 |
| Qera | 52,460,926 | 14,687,202 |
| Shpenzime ligjore e konsulenca | 46,712,333 | 11,931,913 |
| Shpenzime te ndryshme administrativr | 1,292,774 | 3,619,218 |
| Shpenzime per zyrat | 63,144,618 | 10,491,726 |
| Shpenzime Telefon&Internet | 19,640,682 | 9,868,775 |
| Komisione dhe tarifa bankare | 19,813,709 | 3,408,366 |
| Tatime & taksa | 113,054,292 | 27,555,180 |
| Gjoba e demshperblime | 7,213,485 | 652,470 |
| Shpenzime per pritje | - | 211,452 |
| Sponsorizime e donacione | - | 1,303,375 |
| Te tjera shpenzime per personelin | 48,692,130 | 26,230,902 |
| Te tjera shpenzime | 7,903,093 | 6,922,135 |
| Kompensime | 197,371,323 | - |
| Provizione për rreziqe | 25,000,000 | - |
| | **809,442,670** | **252,054,887** |

## 27. Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)

Shpenzimet e interesit (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Te ardhura nga interesat | 70,530 | 41,234 |
| | **70,530** | **41,234** |

## 28. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzimet e tjera financiare (neto) paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Të ardhura të tjera financiare | (672,872,461) | (528,964,076) |
| Humbje nga këmbimet valutore | 682,076,226 | 346,712,899 |
| | **9,203,765** | **(182,251,177)** |

## 29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Sjhpenzimi i tatimit mbi fitimin paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

| | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| ***Fitimi para tatimit*** | **2,403,251,593** |
| **Total shpenzime të panjohura** | **248,084,607** |
| Shpenzime udhetimi | 697,247 |
| Gjoba dhe penalitiete | 15,115,537 |
| Shpenzime pa dokumenta te regullt tatimore | 9,900,500 |
| Kompesim | 197,371,323 |
| Provizion | 25,000,000 |
| ***Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)*** | **2,651,336,200** |
| | |
| ***Tatim fitimi @15%*** | **397,700,430** |
| Korrigjim i Tatim Fitimit | 2,628,646 |
| **Fitimi Neto** | **2,002,922,517** |

## 30. Palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme me palët e lidhura paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

| | 31 dhjetor 2017 | | 31 dhjetor 2016 | |
|---|---|---|---|---|
| | **Të arkëtueshme** | **Të pagueshme** | **Të arkëtueshme** | **Të pagueshme** |
| Spiecapag France | | 744,016,460 | | 3,789,970,595 |
| Spiecapag Transadriatica | 83,711,400 | 1,715,054,871 | 4,037,971,410 | 4,865,616,564 |
| | **83,711,400** | **2,459,071,331** | **4,037,971,410** | **8,655,587,159** |

## 31. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.